

DEMONSTRATION OF NOVEMBER 27, 1968 IN FERIZAJ

Skender Lutfiu

Instituti I Historisë-Prishtinë

Abstract

In this paper, firstly are discussed the general circumstances in Kosovo before 1968 and then the demonstrations in November 1968 in Kosovo, with special emphasis on November 27th in Ferizaj. In details were provided information about the initiative to organize demonstrations in Ferizaj and for the main personalities that from the beginning have contributed to the organization and progress of the demonstration in this city. Demonstration requirements in Ferizaj were almost the same with those of the demonstrations in Prishtina and other cities. What was specific for Ferizaj, is that the authorities have brutally acted against the demonstrators, leaving tens of injured, as opposed to the demonstrations in Gjilan and Podujevo, which have passed without any major incidents. Therefore, it is worth mentioning that in Ferizaj on November 27, 1968, the confrontation between Serbian police forces and demonstrators was very harsh, and consequently dozens were injured.

Keywords: Demonstrations, Ferizaj, police violence, demands, organizers.

DEMONSTRATA E 27 NËNTORIT 1968 NË FERIZAJ

Skender Lutfiu

Instituti i Historisë-Prishtinë

Abstrakt

Në këtë punim janë trajtuar në fillim rrethanat e përgjithshme në Kosovë para vitit 1968 dhe më pas demonstratat e nëntorit të vitit 1968 në Kosovë dhe me theks të veçant demonstrata e 27 nëntorit në Ferizaj. Në mënyrë të detajuar janë ofruar të dhëna rreth nisiativës për të organizuar demonstrata edhe në Ferizaj dhe për personalitetet kryesore që nga fillimi të cilët kanë dhënë kontribut në organizimin dhe mbarëvajtjen e demonstratës në këtë qytet.

Kërkesat e demonstratës në Ferizaj, ishin pothuajse të njejtë me ato të demonstratave në Prishtinë dhe në qytetet e tjera. E veçanta ishte se në Ferizaj, organet e pushtetit kanë ndërhyrë në mënyrë brutale ndaj demonstruesve, që për pasojë ka pasë dhjetra të lënduar, për dallim nga demonstratat në Gjilan dhe në Podujevë, të cilat kanë kaluar pa ndonjë incident të madh. Prandaj, vlen të theksohet se në Ferizaj më 27 nëntor 1968, përballja ndërmjet forcave policore serbe dhe demonstruesve ishte shumë e ashper, ku për pasojë ka pasë dhjetra të lënduar.

Fjalët kyçe: Demonstratat, Ferizaj, dhuna policore, kërkesat, organizatorët etj.

Rrethanat politike në Kosovë nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri më 1968

Kosova dhe viset e tjera shqiptare, që u pushtuan më 1912 nga serbët dhe malazezës dhe mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë politike nga vendimet e Konferencës së ambasadorëve në Londër më 1913, ndërsa pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore u bënë pjesë e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene (1 dhjetor 1918), përjetuan vështirësi të mëdha në të gjitha fushat, krejt kjo për shkak të trajtimit të popullsisë shqiptare nga ana e pushtetit shtetëror të Beogradit. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhe viset e tjera shqiptare, në Kuvendin e Prizrenit më 1945, pa vullnetin e popullit shqiptar u aneksuan nga Serbia. Periudha 1945-1966, për shqiptarët e Kosovës dhe të viseve shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi, karakterizohet me terror shtetëror ndaj tyre, ku vlen të përmendet aksioni i armëve 1956 dhe procesi gjyqësor ndaj krerëve dhe anëtarëve të organizatës Nacional-Demokratike Shqiptare dhe personalitetave të ndryshme shqiptare. Pas Plenumin të Brioneve dhe rënies së Rankoviqit, më 1966, për shqiptarët filloj të dukej në horizont një fije shprese, ngase politika që ndiqte Tito-ja më pas, për t'u hequr si liberal dhe demokrat, ishte më favorizuese për shqiptarët. Megjithatë, shqiptarët ishin larg realizimit të të drejtave më elementare që kishin kombet e tjera në Jugosllavi.

Viti 1968 ishte vit i pakënaqësive të shumta në tërë Europën dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk bënte përjashtim as Jugosllavia, ku pushtetin në Beograd e kishin kapluar skandalet dhe kriza pas komplotit të Rankoviqit kundër Titos. Pakënaqësi të shumta, por të një natyre tjetër kishte edhe në Kosovë. Shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera etnike në Jugosllavi nuk gjzonin të drejtat e plota, sikur popujt e tjerë të kësaj federate. Pas rënies së Rankoviqit, u ngjallën shpresat se pozita e tyre politiko-juridike do të ngritet dhe do të nivelizohet me popujt e tjerë. Ndërsa arsyet e ringjalljes së ndjenjave kombëtare, sigurisht që kanë qenë simpoziumi për 500-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skenderbeut, 90 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Konsulta për njëhsimin e gjuhës letrare e mbajtur në Prishtinë dhe aktivitetet e tjera kulturore e kombëtare, që ndikuan në mobilizimin shpirtëror të masave, saqë në disa qytete flamuri kombëtar u ngrit para se të merret vendimi për lejimin e përdorimit të tij. Në anën tjetër aparati shtetëror dukej më i kujdeshshëm, për shkak të rezikut që e ndjente si rezultat i krizës së brendshme politike.

Demonstratat e 27 nëntorit 1968 në Ferizaj

Të diktuar nga rrethanat e sipershënuara, të cilat u vlerësuan ideale, në nëntor 1968 në Kosovë u organizuan demonstratat gjithëpopullore, nga rinia studentore me në krye Osman Dumoshin, Afrim Lozhën, Adil e Ilas Pirevën, Selatin Novosellën, Skender Kastratin* etj. Pas zhvillimit të demonstratave në Prizren (6 tetor), Therand (8 tetor) dhe Pejë (19 tetor), organizatorët e nivelit qëndror në Prishtinë mbajtën një mbledhje që u zhvillua ndërmjet datave 23 e 24 nëntor 1968, në të cilën u morë vendim unanim që të mbaheshin

* Adil Pireva, në rrëfimin e tij për ideatorët e Demonstratave të 1968-tës ndër të tjera ka thënë: “Ata që më kanë ftuar dhe më kanë pyetur nëse mund të marrë përsipër organizimin e një demonstrate kanë qenë zonja Hyrije Hana dhe z. Ismajl Dumoshi”. Ka studiuës që mendojnë se pjesë të këtij skenari ishte edhe Metush Krasniqin. Për dënimin e tyre nga ana e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, shih: Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales, proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë*. Dokumente. (Prishtinë: pa botues, 2004), 450-459.

demonstratat edhe në qytete të tjera, në të cilat do të kërkohej që pozita e shqiptarëve të avancohej duke u bërë kështu popull shtetformues, të kishin republikën e tyre në kuadër të federatës jugosllave dhe të gjzonin të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara me konventat ndërkombëtare.

Demonstratat u zhvilluan më 27 nëntor 1968, në disa nga qytetet kryesore të vendit, si në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe në Podujevë, në vigjilie të festës së Flamurit dhe Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Nuk bënte përjashtim dhe nuk pritej të bënte përjashtim as Ferizaj, qytet në të cilin tradicionalisht janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme për historinë e kombit shqiptar (kujtojmë Betejën e Slivovës-1881, Kuvendin e Ferizajt-1908, Kryengritjet e viteve 1910-1912, në të cilat treva e Ferizajt dha një kontribut të jashtëzakonshëm, Luftën e Ferizajt 1945 etj), duke pas parasysh pozitën e tij strategjike, në të cilin kryqëzoheshin rrugët që lidhnin qendrat më të rëndësishme shqiptare (Prishtinë me Shkupin, Prizrenin me Gjilanin, etj).

Ndonëse në historiografinë shqiptare, demonstratat e viti 1968 në Kosovë¹, konkretisht në Prizren², Suharekë³, Pejë⁴, Prishtinë⁵, Gjilan⁶, Podujevë⁷ dhe në Tetovë⁸ janë trajtuar deri në një masë, megjithate ka ende hapësirë për të zbardhur të vërtetën e tyre, gjithnjë duke nxjerrë burime të reja nga arkivat e pa hulumtuar më parë. Janë botuar monografi, kumtesa e trajtesa të ndryshme nga studiues të historisë dhe fushave tjera. Edhe për demonstratën e 27 nëntorit 1968 në Ferizaj, janë botuar monografi⁹ dhe punime të

¹ *Historia e Popullit Shqiptar IV*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (Tiranë: Toena 2007); *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 446; Ana Lalaj, *Kosova rruga e gjatë drejt vjetvendosjes 1948-1981*. (Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000), 349-367; Adil Pireva, *Gjashtëdhjeteteta Shqiptare*. (Prishtinë, 1994); Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetetës 1 (Monografi), 2 (dokumente) dhe 3 (Portrete)*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008); *Demonstratat e viti 1968*, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012); etj.

² Meriman Braha, *Demonstrata e Prizrenit më 6 tetor 1968*, në Demonstratat e viti 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 39-54; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, 441-442.

³ Haxhi Bajraktari, *Si u organizua demonstrata e 8 tetorit 1968 në Therandë*, në Demonstratat e viti 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 55-60; Izet Baraliu, *Rrethanat që iu paraprinë demonstratave shqiptare në rrëthin e Therandës më 1968*, vepër e cituar.,295-308; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, vepër e cituar.,442-444.

⁴ Demë Mulliqi, *Rrjedha e demonstratave të '68-ës në Pejë*, Demonstratat e viti 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 61-70; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, vepër e cituar., 444- 445; Shkodran C. Imeraj, *Kontributi i të rinjëve nga komuna e Deçanit në demonstratën e viti 1968 në Pejë*, vepër e cituar.,513-521.

⁵ Haki Kasumi, *Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave të mesme të Prishtinës në demonstratat e viti 1968 në Kosovë*, në Demonstratat e viti 1968, vepër e cituar., 251-256; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, vepër e cituar., 448-452; Sheremet Krasniqi, *Konferenca vjetore e studentëve të Fakultetit Filozofik të Prishtinës për demonstratat e 68-ës*, vepër e cituar., 467-476.

⁶ Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, në Demonstratat e viti 1968, vepër e cituar., 453-454.

⁷ Hakif Sheholli, *Demonstratat e 68-ës në Podujevë*, në Demonstratat e viti 1968, vepër e përmendor., 77-84; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, vepër e përmendor., 454.

⁸ Faik Mustafa, *Demonstratat e 68-ës – Lëvizje e shqiptarëve në Maqedoni*, në Demonstratat e viti 1968, vepër e përmendor., 97- 102; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të viti 1968*, vepër e përmendor., 457-465.

⁹Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*. (Ferizaj: Shoqata e të Burgosurve Politikë-Ferizaj, 2008).

ndryshme shkencore¹⁰, mirëpo ka ende ç'farë të shkruhet, për të zërthyer në mënyrë të detajuar këtë çështje tejet të rëndësishme, jo vetëm për Ferizajn, por në përgjithësi për historiografinë shqiptare. Andaj, në këtë punim do të trajtojmë në mënyrë specifike demonstratën në qytetin e sipershënuar.

Për organizimin e demonstratave në Ferizaj, gjithësesi që janë bërë përgatitje disa muaj më parë, ndërsa për të mobilizuar masat në shkolla, ndërmarrje publike etj, kishin filluar që në pranverë të vitit 1968. Vlen të përmendet se po ashtu në Ferizaj janë zhvilluar disa takime nga organizatorët e nivelit qëndror (Skender Kastrati, Selatin Novosella dhe Osman Dumoshi), ku është diskutuar organizimi i demonstratës në Ferizaj dhe formimi i Këshillit Organizativ. Në këtë këshill bënin pjesë 1. Ismet Ramadani; 2. Hasan Abazi; 3. Avdulla Zymeri; 4. Beqir Beqiri; 5. Muhamet Sylejmani, që të gjithë studentë nga Komuna e Ferizajt.* Për organizimin e demonstratave kontributin më të madh e dhanë studentët e Fakultetit Ekonomiko-Juridik dhe studentët e Fakultetit Teknik. Për të bërë përgatitjet e fundit, Këshilli Organizativ mbajti një mbledhje më 26 nëntor 1968* në hotelin “Luboten”, në të cilën u morën disa vendime si: vendimi për mbajtjen e demonstratës më 27 nëntor 1968, prej orës 14:30 deri 15:30, vendtubimi i demonstruesve te konviki i shkollave të mesme, pastaj që referatin ta shkruaj Ali Mehmeti, ndërsa ta lexojë në sheshin kryesor të qytetit Ismet Ramadani etj. Ndonëse, parullat ishin përgatitur më parë në Prishtinë nga Sherif Beqa, Mehdi Salihu dhe Hasan Abazi, ato u sollën në Ferizaj nga ky i fundit. Në këtë mbledhje u përcaktuan edhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit, në mënyrë që demonstratat të organizoheshin sa më mirë dhe të bëheshin sa më masive.¹¹

Më 27 nëntor 1968, në kohën e përcaktuar, prapa konviktit të shkollave të mesme në Ferizaj, ishin tubuar nxënësit e shkollës së mesme ekonomike, të Shkollës së mesme tenike dhe disa nxënës nga shkolla normale*, të cilët kërcyen nga dritaret e shkollës, si dhe një numër i studentëve. Marshi i demonstruesve, në ballë të së cilës ishin nxënëset si Sherife Syla, Kefsere Hoxha, Lutfije Qerimi, Emine Mustafa, Fatime Vata, Avdije Ilazi, Hazbije Syla, Xhemile Arifi etj, ka filluar nga shkolla ekonomike “Faik Konica”, në drejtim të qendrës së qytetit me flamuj kombëtar, dhe parulla që mbanin në duar. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Sinan Sahiti, kërkoi nga demonstruesit që të shpërndaheshin. Madje ai, së bashku me sekretarin e komitetit të Lidhjes Komuniste, Rasha Mihalloviq, provuan të bisedojnë me organizatorët, por përpjekjet e tyre dështuan.

¹⁰Ali Mehmeti, *Demonstratat e vitit 1968 vazhdimesi e lëvizjes shqiptare të Kosovës*, në Demonstratat e vitit 1968, vepër e përmendor., 85-90; Jakup Mehmeti, *Kontributi i Ismet Ramadanit në veprimtarinë atdhetare në Ferizaj me rrethinë*, vepër e përmendor., 309-313; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, vepër e përmendor., 452-453.

* Për më tepër, për jetën dhe veprën e organizatorëve të demonstratës së vitit 1968 në Ferizaj, shih: Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*, vepër e përmendor., 119-142.

*Në këtë mbledhje morën pjesë: Ismet Ramadani, Ibrahim Sylejmani, Abdullah Zyberi, Mustafë Sejdiu, Beqir Beqiri, Hajredin Salihu, Hasan Abazi, Ibrahim Sylejmani dhe Hysen Muhamheri. Shih: Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetëtës*. 1 Monografi. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008), 133; Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*. (Ferizaj: Shoqata e të Burgosurve Politikë-Ferizaj, 2008), 69.

¹¹Ali Mehmeti, *Demonstratat e vitit 1968 vazhdimesi e lëvizjes shqiptare të Kosovës*, në Demonstratat e vitit 1968, vepër e përmendor., 88; Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*, vepër e përmendor., 70-71.

* Sipas nxënësve të Normales së Ferizajt, atë ditë drejtoria ua kishte mbyllur dyert e shkollës, për t'u pamundësuar daljen në demonstratë.

Sipas Beqir Beqirit, njërit nga organizatorët¹², demonstruesit shqiptarë janë përleshur me forcat e rendit, para xhamisë së madhe ku kordoni i policisë është shpartalluar nga demonstruesit të cilët vazhduan më pas drejtë sheshit të qytetit, që ndodhej përbull objektit të komunës. Nga kjo përleshje mbeten të lënduar shumë qytetar. Vlen të thuhet se pikërisht në këtë përbullje me policinë, në krye të demonstratës u vun studentët, ndërsa më parë ishin nxënësit e shkollave të mesme. Po ashtu, pas thyerjes së kordonit të policisë, masa e revoltuar filloi të brohoriste “Vetëvendosje”, “Kushtetutë”, “Republikë”.¹³

Sipas llogaritjeve të shumta del që në sheh të jenë grumbulluar mijëra demonstrues, para të cilëve është lexuar referati nga Ismet Ramadani, ndërsa është shkruar nga Ali Mehmeti. Në këtë referat ndër të tjera thuhej: “*Ne, bijtë e Skënderbeut, që me shekuj luftuam për liri e për të drejtat tona, që derdhëm gjak për Kosovën martire, jemi duke demonstruar sot kundër shkeljes së të drejtave tona, kundër atyre që mohuan qenien tonë në këto troje dhe duke kërkuar që edhe ne të kemi të gjitha ato të drejta që i kanë popujt tjerë të Jugosllavisë... Rrofti populli shqiptar! Rroftë Republika e Kosovës!*¹⁴ Ndonëse, këtë referat nuk mund ta gjejmë në arkiva, meqë është eliminuar nga forcat serbe, sipas historianit dhe njërit ndër organizatorët, Beqir Beqiri ndër pikat kryesore të tij ishin: 1. Kosova Republikë; 2. Vetvendosja-Kushtetutë; 3. Duam Universitet etj. Këto kërkesa ishin paraqitur edhe në parullat që mbanin në duar demonstruesit e shumtë në qendër të Ferizajt, disa nga të cilat janë shkruar nga Hasan Abazi, Avdulla Zymeri dhe Mehmet Sylejmani, ndërsa nga rruga “Zenel Hajdini” deri te shkolla ekonomike, ato u transportuan nga Beqir Beqiri. Demonstruesit në Ferizaj kanë brohoritur edhe parullën “Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë”.¹⁵

Ndonëse demonstruesit shqiptarë ishin të qetë dhe protestonin për të drejtat e tyre kombëtare e qytetare, forcat policore ndërhynë në mënyrë mjaftë brutale duke përdorur autocisternën e zjarrfikësve, shufra gome dhe topa të ujit, së pari në drejtim të Ismet Ramadanit, derisa ishte duke e lexuar referatin dhe më pasë ndaj gjithë organizatorëve dhe demonstruesve, që për pasojë mbeten të lënduar Ismet Ramadani dhe Hasan Abazi. Por, sipas një raporti mjeksor mësojmë që mbi 45 qytetarë kanë kërkuan ndihmën mjeksole. Megjithë ndërhyrjen brutale të forcave të rendit ndaj demonstruesve, ata shpartalluan policinë dhe au morën autocisternën, që më pas të pa penguar marshuan rrugës kryesore të qytetit deri në orën 16:00.¹⁶ Vlen të përmendet se në orën 15:15 min numri i demonstruesve ishte rrëth 5.000 veta, shifër që trembi policinë, UDB-në dhe zjarrfikësit, të cilët u larguan nga sheshi para ndërtesës së Komunës së Ferizajt¹⁷, për t'u rikthyer më pas rrëth orës 16:00, ku në qytet erdhën njësi speciale të policisë jugosllave, të cilat filluan terrorin ndaj demonstruesve që gjelin në qytet. Kjo ishte arsyaja që këshilli organizues, të kërkojë nga demonstruesit që të shpërndaheshin sa më parë.¹⁸

Pas përfundimit të demonstratës në Ferizaj, që mund të thuhet se ishin ndër më masoviket dhe më të zhëshmet në Kosovë, disa nga organizatorët shkuan në Prishtinë, për

¹² Intervistë e realizuar me Beqir Beqirin, më 20 shtator 2018, në Ferizaj.

¹³Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*, vepër e përmendor., 78.

¹⁴ Po aty., 9.

¹⁵Po aty., 155.

¹⁶Ali Mehmeti, *Demonstratat e vitit 1968 vazhdimësi e lëvizjes shqiptare të Kosovës*, në *Demonstratat e vitit 1968*, vepër e përmendor., 89.

¹⁷Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetëtetës I*. Monografi. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008), 140.

¹⁸Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*, vepër e përmendor., 216.

t’iu bashkuar demonstratës në kryeqytet, e cila zgjati deri rrith orës 12 të mbrëmjes, e ku fatkeqësish mbeti i vrarë demonstruesi Murat Mehmeti. Më pas disa nga organizatorët e demonstratës së Ferizajt nga Prishtina u nisën me tren në drejtim të Shkupit, ku qëndruan katër ditë tek familjet e Faik Kosharës dhe Hamdi Hodës. Jo vetëm që i mbajtën në shtëpitë e tyre, por këta u thanë që nëse duan, mund t’i dërgonin në Shqipëri, mirëpo ferizajasit nuk pranuan, megjithëse i dinin pasojat e vazhdimit të qëndrimit të tyre në Shkup. Pas katër dite, policia e Ferizajt shkoi në Shkup dhe pas arrestimit të tyre, i ktheu në Ferizaj, për t’i ndëshkuar më pas, me justifikim për veprimitari armiqësore kundër popullit dhe shtetit, sankzionuar me nenin 116 të KP të Jugosllavisë. Mirëpo, pas disa dite kthyen akt vendimet e tillë dhe shqiptuan të tjera me akuzën kundërvajtje, të bazuar nga neni 2 pika 2 e Ligjit mbi kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike. Sipas Sylejman Bytyçit, pjesëmarrës aktiv i demonstratës, inspektorët e UDB-së ishin shqiptarët Nezir Qerimi nga Kosharja, Kemajl Shehu nga Kaçaniku, Shefqet Hashani nga Gremja dhe Mustafa Sefedini nga Ferizaj, por i angazhuan në Drejtoren qendrore të UDB-së në Prishtinë. Sipas tij, ndërhyrje ka pas edhe nga serbi Vela Vujoviq, që ishte shef i UDB-së në Ferizaj.¹⁹

Pra pas përfundimit të demonstratës nisi aksioni për burgosjen e organizatorëve, nga ana e organeve të shtetit, me arsyetimin për “veprimitari armiqësore”. Kështu, pushteti aktual, nëpërmjet organeve të rendit publik, arrestoi përvçe organizatorëve që ndodheshin në Shkup edhe disa nga studentët dhe nxënësit, pjesëmarrës në demonstratë, si dhe mësimdhënësit e Shkollës së mesme ekonomike Ali Mehmetin, Jakup Mehmetin dhe Sali Hasanin. Vlen të përmendet se Jakup Mehmeti pas qëndrimit në paraburgim prej 15 ditësh, lirohet për t’u mbrojtur në liri, ndërsa Sali Hasan lirohet i pafajshëm.²⁰

Kështu, më 7 prill 1969 shpallet aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, me të cilin, për organizim të demonstratave, dënohen:

1. Ismet Ramadani – dhjetë muaj;
2. Hasan Abazi – dhjetë muaj;
3. Ali Mehmeti – dympëdhjetë muaj²¹;
4. Beqir Beqiri- një muaj;
5. Muhamet Sulejmani – një muaj;
6. Avdulla Zymeri – një muaj.
7. Mehmet Emërrlahun -15 ditë burg.

Ali Mehmeti e vuajti dënimin në Goli Otok, ndërkaq Ismet Ramadani* dhe Hasan Abazi e vuajtën në burgun e Ferizajt. Po ashtu, janë arrestuar dhe dënuar me nga një muaj burg edhe nxënësit Sylejman Bytyi, Hasan Muhamxheri dhe Ekrem Beqiri. Organizatorët e

¹⁹ Intervistë e realizuar me Sylejman Bytyçin, më 21 tetor 2018, në Ferizaj.

²⁰ Ali Mehmeti, *Demonstratat e vitit 1968 vazhdimi i lëvizjes shqiptare të Kosovës*, në Demonstratat e vitit 1968, vepër e përmendorur, 85.

²¹ Aktgjykimi i plotë i Gjyqit Komunal të Ferizajt kundër Ismet Ramadani, Hasan Abazit dhe Ali Mehmetit është botuar i plotë në këtë vepër: Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashëdhjetetës 2. Dokumente*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008), 146-159.

* Ismet Ramadani më 3 dhjetor 1968, u arrestua nga organet e Sigurimit Shtetëror, për shkak se ishte ndër organizatorët e demonstratave në Ferizaj dhe lexues i referatit para demonstruesve në sheshin e qytetit në Ferizaj. Qëndroi në paraburgim deri më 7 prill 1969, ku gjykohej me 10 muaj burg, të cilat i mbajti në burgun e Ferizajt. Për jetën dhe veprën e tij, për më tepër shih: Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*. (Ferizaj: Shoqata e të Burgosurve Politikë-Ferizaj, 2008) 123-125; Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashëdhjetetës 3. Portrete*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008) 90-96; Jakup Mehmeti, *Kontributi i Ismet Ramadaniit në veprimtarinë atdhetare në Ferizaj me rrëthinë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 309-313.

demonstratës në Ferizaj janë dënuar me burg ngase ishin “fajtor” për shkak: “*që me qëllim nxitjeje të ndasisë nacionale në mesë të popujve që jetojnë në Kosovë, mbas marrëveshjes me Osman Dumoshin, Skender Kastratin dhe Hasan Dermakun, organizues të demonstratave armiqësore në krahinë, kanë marrë mbi vedi organizimin e demonstratave në Ferizaj e që janë mbajtur më 27 nëntor 1968, me ç'rast janë hedhë parulla të llojlojshme, edhe pse kryetari i Kuvendit komunal ka kërkuar që demonstruesit të shpërndahen, këta nuk kanë dëgjuar, e që si pasojë kanë patur çrregullimin e përgjithshëm, përlleshjet me organet e rendit publik, lëndimet trupore në të dy anët si dhe damin material*”.²²

Përveç dënimeve me burg, organizatorët dhe pjesëmarrësit e lartëshënuar në demonstratë janë përballur me diskriminim të vazdueshëm nga ana e pushtetit jugosllav.

Për demonstratrat e 27 nëntorit në Kosovë, respektivisht në Ferizaj ka shkruar edhe e përditshmja e vetme në gjuhën shqipe “Rilindja”, në numrin e saj të 30 nëntorit 1968. Natyrisht, që duke qenë e ndikuar nga pushteti demonstratat janë paraqitur si reaksionare, duke i pasqyruar si përpjekje të disa individëve për të penguar demokratizimin e jetës politike. Më tej jepet mbledhja e Komitetit Krahinor, që është mbajtur më 28 nëntor 1968 dhe aprovimi i Komunikatës së komitetit, në të cilën ndër të tjera thuhet: “*Afirmimi dhe politika e denjë e barazisë nacionale dhe vëllazënimit dhe bashkimit, ngritja permanente e vetëqeverisjes, përkrahja e parezervë e pjesëtarëve të të gjitha kombësive kësaj politike, rritja permanente e ndikimit dhe prestigjitet të Lidhjes së Komunistëve, posaçrisht në mesin e kombësisë shqiptare, i qet anmiqët dhe kundërshtarët e këtyne orientimeve në skenën e hapun politike, i detyron me zbulue fytyrën e tyne të vërtetë dhe me tregue haptazi pozitat e tyne plotësisht reaksionare dhe metodat e tyne destruktive...*”.²³ Po ashtu, në këtë numër të “Rilindjes”, jepen edhe disa komunikata si ajo e “Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Rinisë”, pastaj komunika e “Kryesisë së Lidhjës së studentëve të Kosovës dhe Metohisë” dhe “Sekretariatit të Konferencës së LK të shkollave të nalta e fakulteteve”, etj, ku shprehej në mënyrë të ashpër kundërshtimi i kërkeseve të demonstratave dhe kërkohet që të dënoheshin organizatorët e tyre. Vlenë të përmendet se në Komunikatën e dytë të Këshillit Ekzekutiv Krahinor, për demonstratat e 27 nëntorit ndër të tjera thuhet: “*Demonstratat në Ferizaj kanë pasë përpjeste ma të vogla, kurse në Gilan dhe në Podujevë kanë kalue pa incidente*”.²⁴

Pasqyrimi i demonstratave të 27 nëntorit 1968 në shtypin e kohës, fletë mjaftë shumë për tendencat e organeve të pushtetit, të cilat synonin, që këto demonstrata të pasqyrohen jo si përpjekje e shqiptarëve për ngritjen e pozitës së tyre në kuadër të Jugosllavisë, por më tepër si përpjekje e disa individëve, kryesisht të ndikuar nga agjenturat e huaja, për të shkatërruar siq shpreheshin ata “vëllazërim-bashkimin”.

Si përfundim, mund të themi se efektet e demonstratave të 68-tës në tërë Kosovës, ishin të dukshme, ngase pushteti u detyrua të ndërmarrë menjëherë masa për përmirësimin e pozitës kushtetuese të shqiptarëve*. Kjo ngase, demonstratat u zhvilluan në periudhën më të

²²Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashëdhjetetës 2. Dokumente*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008), 149.

²³ “*Forcat reaksionare po përpiken me e pengue demokratizimin e jetës politike te na*”. Rilindja. Prishtinë, 30 nëntor 1968, 1.

²⁴ “*Komunikata e dytë e Këshillit Ekzekutiv Krahinor*”. Rilindja. Prishtinë, 30 nëntor 1968, 7.

* U lejua, përdorimi i gjuhës shqipe në shkolla dhe në administratë, pra u zyrtarizua gjuha shqipe në Kosovë, u lejua përdorimi i flamurit kombëtar, u morë vendimi për hapjen e Universitetit të Kosovës (1969) etj.

vështirë për pushtetin në Beograd, andaj ato demaskuan propagandën e një oaze të paqes, barazisë dhe harmonisë mes kombeve e kombësive në Jugosllavi.

Literatura

1. Ali Mehmeti, *Demonstratat e vitit 1968 vazhdimësi e lëvizjes shqiptare të Kosovës*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 85-90.
2. Jakup Mehmeti, *Kontributi i Ismet Ramadani në veprimtarinë atdhetare në Ferizaj me rrëthinë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 309-313.
3. Rrahim Sadiku, *Ferizaj '68*. (Ferizaj: Shoqata e të Burgosurve Politikë-Ferizaj, 2008).
4. Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetetës 1 (Monografi), 2 (dokumente) dhe 3 (Portrete)*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008).

Literatura e konsultuar:

1. Adil Pireva, *Gjashtëdhjeteteta Shqiptare*. (Prishtinë, 1994).
2. Ana Lalaj, *Kosova rruga e gjatë drejt vetvendosjes 1948-1981*. (Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000).
3. Demë Mulliqi, *Rrjedha e demonstratave të '68-ës në Pejë*, Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 61-70.
4. Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales, proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë*. Dokumente. (Prishtinë: pa botues, 2004), 450-459.
5. Faik Mustafa, *Demonstratat e 68-ës – Lëvizje e shqiptarëve në Maqedoni*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 97- 102.
6. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 446.
7. Haki Kasumi, *Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave të mesme të Prishtinës në demonstratat e vitit 1968 në Kosovë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 251-256.
8. Hakif Sheholli, *demonstratat e 68-ës në Podujevë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 77-84.
9. Haxhi Bajraktari, *Si u organizua demonstrata e 8 tetorit 1968 në Therandë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 55-60.
10. *Historia e Popullit Shqiptar IV*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (Tiranë: Toena 2007).

11. Izet Baraliu, *Rrethanat që iu paraprinë demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968*, 295-308; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, 442-444.
12. Meriman Braha, *Demonstrata e Prizrenit më 6 tetor 1968*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 39-54.
13. Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, 452-453.
14. Sheremet Krasniqi, *Konferenca vjetore e studentëve të Fakultetit Filozofik të Prishtinës për demonstratat e 68-ës*, 467-476.
15. Shkodran C. Imeraj, *Kontributi i të rinjëve nga komuna e Deçanit në demonstratën e vitit 1968 në Pejë*, 513-521.

Intervistat:

1. Intervistë e realizuar me Beqir Beqirin, më 20 shtator 2018, në Ferizaj.
2. Intervistë e realizuar me Sylejman Bytyçin, më 21 tetor 2018, në Ferizaj.

Shtypi:

1. Rilindja, Prishtinë. 30 nëntor 1968.